



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.34/2018  
Prishtinë, më 03.7.2018, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Liburn Aliu, Glauk Konjufca, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

**Pjesëmarrës:** Gentian Berbati – KDI, Liridon Gashi – SEEF, Besiana Dauti – Ekonomia Online, Ismail Shabani – Kosovapress.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurie Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.6.2018;
3. Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për vitin 2017;
4. Realizimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2018, periudha janar – qershor;
5. Të ndryshme.

*Me autorizim të kryetares, në mungesë të zëvendëskryetarëve të komisionit dhe me miratim të komisionit, kryesimin e mbledhjes e vazhdoi deputeti më i vjetër i komisionit, z. Bilall Sherifi.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.6.2018**

*Procesverbali i mbledhjes së datës 26.6.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për vitin 2017**

**Kryesuesi** theksoi se për këtë pikë të rendit të ditës është shterur debati në mbledhjen e fundit dhe e hodhi në votim.

*Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë*

*Përfundim:*

*I. Miratohet Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për vitin 2017;*

*II. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), për vitin 2017;*

*III. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja, Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

## **4. Realizimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2018, periudha janar - qershor**

**Kryesuesi** theksoi se tashmë po përfundon gjashtëmuajori i parë i vitit 2018 dhe temë diskutimi kemi shqyrtimin e Planit të punës së komisioni, ku të shohim se sa e kemi realizuar. Më pas, hapi debat.

**Glauk Konjufca**, theksoi se sa i përket planit të punës, në kuadër të vizitave të parapara ndërmarrjeve publike, të fokusohemi te Telekomit i Kosovës, për shkak të problemeve më të mëdha që ka kjo ndërmarrje. Ai propozoi që të bëhet një grup që do ta trajtojë më thellësisht çështjen e Telekomit të Kosovës dhe ta vizitojë atë.

**Mimoza Kusari – Lila**, nënvizoi se vizitat e parapara bizneseve nuk i kemi bërë, andaj, në kohën që ka mbetur në këtë sesion dhe në sesionin vjeshtor, të fokusohemi në vizitat te bizneset, në mënyrë që të kemi informacion të drejtpërdrejtë për sfidat e bizneseve në përgjithësi, si dhe për ndikimin e ligjeve nga fusha që mbulon ky komision.

**Memli Krasniqi**, potencoi se sa i përket realizimit të planit jemi në rrugë të mbarë, janë miratuar shumë ligje, disa presin të miratohen në seancën e radhës. Ne duhet të fokusohemi në vizitat bizneseve private. Po ashtu, shihet se ka mbetur pa u shqyrtuar Projektligji për produktet e ndërtimit dhe për këtë të kërkojmë nga kryesuesja e grupit punues që të dinamizohet shqyrtimi i këtij projektligji, në mënyrë që ta kryejmë para përfundimit të sesionit. Ai propozoi që për

Projektligjin për efikasitet të energjisë, të themelohet një grup punues. Më tej, tha se patëm kërkuar që të ftohet në raportim ministri i Zhvillimit Ekonomik, që të raportojë lidhur me zbatimin e memorandumit me ndërmarrjen publike “Posta e Kosovës” dhe problemet e saj, andaj propozoi që të thirret ministri.

**Liburn Aliu**, kërkoi që të përfshihet në grupin punues për produktet e ndërtimit.

**Mimoza Kusari – Lila**, sqaroi se vizita e paraparë e Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht komisionit homolog, nuk është realizuar ende, për shkak të agjendës së komisionit homolog të Kuvendit të Shqipërisë dhe jemi në pritje të konfirmimit për kohën e përshtatshme.

**Glauk Konjufca**, theksoi se duke analizuar raportin e AKP-së, kemi vërejtur se AKP-ja, prej aseteve të lëshuara me qira, arrin të mbledhë vetëm një pjesë të caktuar. Do të duhej të dihet se cilat qira nuk mblidhen, pse nuk mblidhen qiratë nga asetet në veri, pse nuk lirohen asetet në veri? Andaj, propozoj që të kemi një grup pune, që t’i i shqyrtojmë më në detaje këto probleme.

*Pas debatit, komisioni nxori këtë*

*Përfundim:*

- 1. Komisioni, muajt në vijim, të fokusohet në vizitat te sektori prodhues dhe bizneset vendore;*
- 2. Të përshpejtohet shqyrtimi i Projektligjit për produktet e ndërtimit;*
- 3. Deputeti Liburn Aliu, i bashkohet grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për produktet e ndërtimit;*
- 4. Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për efikasitet të energjisë, në këtë përbërje: Dardan Sejdiu, kryesues, Sala Berisha- Shala, Liburn Aliu dhe Mimoza Kusari- Lila, anëtarë;*
- 5. Të thirret në komision, ministri i Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, që të raportojë lidhur me problemet e zbatimit të Memorandumit me ndërmarrjen publike, Posta e Kosovës;*
- 6. Të realizohet vizitë mbikëqyrëse në AKP, për të parë nga afër punën e AKP-së;*
- 7. Të formohet një grup pune për gjendjen e krijuar në ndërmarrjen publike, Telekomit i Kosovës.*

## **5. Të ndryshme**

**Çështjet vijuese**

**Mbledhja përfundoi në orën 14:00.**

**E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetarja e komisionit,**

-----  
**Sala BERISHA SHALA**